



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER BLERINA J. AVRAZI  
ADRESA NR.10, RR. E DURRESIT,  
NR.204, NR.3, NR.25  
TEL: 692061217

## REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

Nr. repertori: 2442

Nr. koleksioni: 480

Tirane më 13/12/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024053000053661181



A2024053000053661181

**AKTI I THEMELIMIT****TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR****"UNICORN SERVICES" SH.P.K.**

Sot, më datë 13.12.2024, para meje Notere BLERINA J. AVRAZI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.10, RR. E DURRESIT, NR.204, NR.3, NR.25, u paraqit personalisht:

**THEMELUESI/ ORTAKU I VETEM:**

**Kodret Zeneli**, atësia Sali, amësia Hajdije, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë: Sharrë; Nd. 060; Njësia Administrative Nr. 6; Njesia Bashkiake Nr. 6; 1027; Tiranë, lindur më 17/09/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038567063 dhe nr. personal J10917069G, i cili me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, me kerkoi hartimin e këtij Akt Themelimi per krijimin e shoqerise pergjegjesi te kufizuar me emertimin "UNICORN SERVICES" sh.p.k. mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" te ndryshuar me Ligjin Nr. 129/2014, Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar, Ligjin Nr.131/2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", Ligji 9262 datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Legjislacionin Fiskal e Tatimor.

**KREU I****Neni 1****Emertimi**

Shoqeria emertohet "UNICORN SERVICES" sh.p.k., ajo eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

**Neni 2****Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria "UNICORN SERVICES" sh.p.k, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga "ortaku i vetem", i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

**Neni 3****Selia**

Shoqeria e ka seline kryesore ne Tirane, ne adresen: **Rr."Prokop Mima", Ndertesa nr 4, Shkalla 3, Kati 5. Tirane.** Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem.

**Neni 4****Objekti i veprimtarise**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetet ne keto fusha:



A2024053000053861181

- o Ideim, zhvillim, prodhim dhe keshillim ne realizimin e sistemeve baze si dhe cdo gje tjeter qe ka te beje me ruajtjen, trajnimin dhe menaxhimin e te dhenave.
- o Ofrimi i sherbimeve te keshillimit te biznesit ne menaxhim dhe informatike, trajnimin, keshillimit dhe organizimit te ceshtjeve te menaxhimit, kerkime dhe zhvillime te marketingut dhe metodave te futjes ne treg.
- o Studimi, zhvillimi dhe realizimi i faqeve te internetit, faqe te aksesueshme web design si dhe regjistrime, mirembajtje dhe shitje domain internet – housing (administrim, depozitim dhe lidhje) si dhe cdo gje tjeter qe eshte e nevojshme per asistence ne fushen e informatikes
- o Projektim, realizim dhe dergim te fushatave promocionale nepermjet posteselektronike, mesazheve, fakseve, telefonatave vokaleautomatike dhe rrjeteve sociale.

#### **Neni 5 Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB

#### **KREU II KAPITALI**

#### **Neni 6 Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë (njqindmijë lekë).

Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga “ortaku i vetëm “ i shoqërisë:

Z. Kodret Zeneli, është zotërues i 1 kuote me vlerë 100.000 leke, e cila përfaqëson 100 % te kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

#### **Neni 7 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit të nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetem në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar.

#### **Neni 8 Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;



A202403000033661181

- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.

Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## KREU II

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 9

##### Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.


Ortaku i vetem, vendos për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.



A2024053000033681181

## Neni 10 Administrimi

Administrator i shoqërisë është z. **Kodret Zeneli**, atësia Sali, amësia Hajdije, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë: Sharrë; Nd. 060; Njësia Administrative Nr. 6; Njësia Bashkiake Nr. 6; 1027; Tiranë, lindur më 17/09/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i Leternjoftimit ID nr. 038567063 dhe nr. personal J10917069G.

Administratori i shoqërisë do të ushtroje kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejte ripërteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetem të shoqërisë. Administrator i shoqërisë mund të emerohet edhe një person i tretë jashtë ortakerisë.

## Neni 11 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga ortakët e vetëm;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur:

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave të të gjitha niveleve, zyrave të tatimit taksave, autoriteteve doganore, përfshirë këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.



A2024053000053661191

Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar shoqërisë. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë mbledhjen e ortakut për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.

Nëse ortaku nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Biznesit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes dhe Qendra Kombëtare e Biznesit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", të ndryshuar.

Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji".

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

## Neni 12

### Përgjegjësia

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetëm që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
  - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
  3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.



A2024053000053661181

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëshmohet shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

#### **Neni 13** **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 dhjetor.

#### **Neni 14** **Bilanci i shoqerise dhe dividendet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut te Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### **Neni 15** **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" te ndryshuar me Ligjin Nr. 129/2014, Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar, Ligjin Nr.131/2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", Ligji 9262 datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Legjislacionin Fiskal e Tatimor, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

#### **Neni 16** **Dispozita perfundimtare**

Autorizohet administratori i shoqerise, te depozitoje kete akt themelimi dhe statutin e shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe te ndjeke te gjitha procedurat ligjore per regjistrimin e saj si person juridik.

Ky Akt themelimi i shoqerise "UNICORN SERVICES" sh.p.k, u redaktua me vullnetin te lire e te plote te "ortakut themelues", ne 4 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe dhe nenshkruhet regullisht sipas ligjit.

**ORTAKU I VETEM**

**Kodret Zeneli**

*Kodret Zeneli*